



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHËSHME E RRUGËVE DHE NDRIÇIMIT PUBLIK
DREJTORIA JURIDIKE DHE PROKURIMEVE

SHTOJCË

Për modifikimin e dokumentave të tenderit për procedurën e prokurimit **me objekt të kontratës** “*Materiale për mirembajtjen e Sinjalistikës Unaza e Madhe*” me numër reference **REF- 84440-05-06-2026**.

Fondi limit: 60,088,333 (gjashtëdhjetë milion e tetëdhjetë e tetë mijë e treqind e tridhjetë e tre pikë tridhjetë e tre), lekë pa TVSH.

Vlera e fondit limit në monedhën ndërkombëtare euro sipas kursit të Bankës së Shqipërisë është 627,226.858 (gjashtëqind e njëzet e shtatë mijë e dyqind e njëzetë e gjashtë pikë tetëqind e pesëdhjetë e tetë) euro pa TVSH.

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë për monedhën euro në datë 05.05.2026 është 95.80 euro.

I mbajtur në datën **08.05.2026** nga Njësia e Prokurimit, për procedurën e prokurimit me objekt: **“Materiale për mirembajtjen e Sinjalistikës Unaza e Madhe”**.

Në zbatim të nenit 75 të ligjit nr.162/2020, dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), e cila ka bërë ndryshimet në dokumentat standarte të tenderit si më poshtë vijon:

Me iniciativën e Autoritetit Kontraktor hartojmë shtojcën si më poshtë vijon:

ISHTE

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 40 % e vlerës së fondit limit objekt prokurimi**.

Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës ose/dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

BËHET

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 40 % e vlerës së fondit limit objekt prokurimi**.

Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

ISHTE

2.3.3 Operatori ekonomike duhet të paraqesë për mallrat objekt prokurimi, katalogun dhe/ose skedat teknike, në gjuhën shqipe ose anglisht, të botuara nën autoritetin e prodhuesit, që nënkupton se duhet të jenë me logon e tij dhe ku jepen të gjitha karakteristikat teknike të këtyre materialeve me qëllim që autoriteti kontraktor të verifikojë përmbushjen e specifikimeve teknike.

BËHET

2.3.3 Operatori ekonomike duhet të paraqesë për mallrat objekt prokurimi, katalogun dhe skedat teknike, në gjuhën shqipe ose anglisht, të botuara nën autoritetin e prodhuesit, që nënkupton se duhet të jenë me logon e tij dhe ku jepen të gjitha karakteristikat teknike të këtyre materialeve me qëllim që autoriteti kontraktor të verifikojë përmbushjen e specifikimeve teknike.

NJËSIA E PROKURIMIT